

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe Burim Shala e Lumni Sallauka – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.S. nga Mitrovica, rr. "...", .-., nr..., të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av.SH.SH. nga Gjilani rr. "...", p.n. kundër të paditurës Banka Ekonomike Sh.A, me seli në Prishtinë, rr. "Migjeni", nr.1, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj juristi F.B., për shkak të anulimit të aktvendimit dhe kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1240/13, të datës 03.07.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 23.10.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e të paditurës Banka Ekonomike Sh.A, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1240/13, i datës 03.07.2017, **VËRTETOHET**.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses S.S. nga Mitrovica, me të cilën ka kërkuar që të anulohen si jo ligjore vendimet e të paditurës me nr.2050, të datës 21.03.2013 dhe vendimi nr.3005, i datës 22.04.2013 dhe të detyrohet e paditura Banka Ekonomike Sh.A., me seli në Prishtinë, që paditëses t’ia kompensoj të ardhurat personale për periudhën nga data 01.07.2013, e deri me datë 31.10.2014, në shumën e përgjithshme prej 2,820.27 €, në emër të shpërblimit të dëmit në lartësinë e pagave të pa paguara, kontributit personal në vlerë prej 154.50 €, tatimit në këto paga që e paditura duhet t’i paguaj Administratës Tatimore në vlerë prej 154.50 € dhe kamatën që duhet paguar paditëses në shumën prej 640.69 €, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,094.00 €, e të gjitha këto në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e Bankës Ekonomike me seli në Prishtinë si të themeltë, ta ndryshoj tërësisht aktgjykimin C.nr.1240/2013, të datës 03.07.2017, të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe ta refuzoj padinë e paditëses si të pathemeltë. Po ashtu ka kërkuar që ta obligoj paditësen t’i bart të

gjitha shpenzimet procedurale dhe pagesën e shpenzimeve t'ia bëjnë paditësit brenda 7 ditëve nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja S.S. me datë 27.05.2013, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Banka Ekonomike Sh.A., me seli në Prishtinë, për kthim në vendin e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe shpalljen të kundërligjshme të largimit nga puna e paditëses. Në ndërkohë dhe përgjatë zhvillimit të procedurës, paditësja përmes të autorizuarit të saj, duke marrë për bazë ekspertizën e ekspertës financiare (si dhe ekspertizën e plotësuar), të datës 22.05.2017, e ka precizuar kërkespadinë e saj në bazën dhe shumën sikurse që është aprovuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1240/13, të datës 03.07.2017, me të cilën e ka aprovuar në tërësi kërkespadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimin, gjykata ka arsyetuar se nuk është kontestues fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura, sipas kontratës së punës të datës 04.10.2011, në pozitën e arketares, në degën e të paditurës në Mitrovicë deri me datë 31.10.2014, me mundësi vazhdimi të kontratës. Kontestuese ishte fakti që ka të bërë me ligjshmërinë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, e gjithashtu kontestuese ishte mënyra e ndërprerjes së marrëdhënies së punës konkretisht vendimi me nr.2050, i datës 21.03.2013, i cili vendim paditëses i është dorëzuar asaj po të njëjtën datë, ku i ndërprehet marrëdhënia e punës, pra me datën 30.03.2013, me arsyetimin se për shkaqe ekonomike dhe organizative të bankës, asaj i ndërprehet kontrata e punës. Më tutje gjykata ka arsyetuar se e paditura nuk ka vlerësuar objektivisht mundësinë e ri sistemimit të punëtores dhe dhënien e mundësisë për tu angazhuar në detyra të njëjta të punës, që ka rezultuar të ketë qenë e nevojshme për të paditurën pasi me datë 08.04.2014, e ka pranuar punëtores tjetër në detyrat e punës në të cilat më parë ka qenë e angazhuar paditësja. Në vijim gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga ekspertiza financiare e datës 03.04.2017, e punuar nga ekspertja financiare M.M. dhe e plotësuar me datën 22.05.2017, nga po e njëjta eksperte, është konstatuar se sikur paditësja të punonte në këtë pozitë në periudhën nga data 01.07.2013, e deri me 31.10.2014 dhe pasi që paditësja ka punuar në Ministrinë e Administratës Publike në Prishtinë, llogaritja në emër të diferencës së pagave të papaguara, e njëjta për periudhën e lartcekur do të realizonte pagë neto në shumë prej 2,820.27 €, e cila shumë i takon asaj në emër të shpërblimit të dëmit në lartësinë e pagave të papaguara. Po ashtu në emër të kontributit personal, që duhet paguar në Trustin Personal është llogaritur shuma prej 154.50 €, në emër të tatimit në pagë që duhet paguar në Administratën Tatimore të Kosovës shuma prej 154.50

€, si dhe në emër të interesit që duhet paguar punëtores shuma prej 640.69 €, e cila është llogaritur nga data 01.07.2013, e deri me datën 28.03.2017, duke aplikuar kamatën 8 %, konform nenit 382.2 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e ka bazuar në nenin 449 dhe 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar drejtë të drejtën materiale në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese nga ku ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Me nenin 78 të (LP) parashihet se *“i punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”*. Kurse me nenin 79 të të njëjtit ligj ceket se *“çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente .*

Fillimisht gjykata e vlerësoi të pabazuar pretendimin ankimor të paditurës, të shprehur edhe përgjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, lidhur me afatshmërinë e padisë për shkak se në bazë të nenit 87 të Ligjit të punës (LP) nr.03/L-212, të datës 01.11.2010, saktësisht parashihet se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, për çka duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar të drejtën materiale, në këtë drejtim e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike.

Tutje, në rastin konkret paditësja si punëmarrëse ka vlerësuar se të njëjtës i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës nga këtu e paditura, si punëdhënëse, për çka e njëjta bazuar në nenin 78 të lartcitur, si dhe duke marrë për bazë shkresat e lëndës, ka parashtuar kërkesë për realizimin e të drejtave të pretenduara të shkeluara nga ana e të paditurës. Meqenëse e paditura kërkesën e paditëses për realizimin e të drejtave të saja e kishte refuzuar, ajo pastaj në pajtim me nenin 79 të LP të lartcitur, brenda afatit ligjor, i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me padi për kontest pune dhe me kërkesë sikurse në shkresat e lëndës.

Në bazë të nenit 76 të Ligjit të Punës (LP) nr. 03/L-212, parashihet se *“ndërprerja e Kontratës së Punës sipas nën-paragrafit 1.1. të paragrafit 1 të nenit 70, të këtij ligji ku përfshihen së paku 10% të të punësuarave por jo me pak se njëzet (20) të punësuar, të larguar brenda intervalit kohor prej gjashtë (6) muajsh, konsiderohet si largim kolektiv nga*

puna; 2. Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna, zbatohen dispozitat nga paragrafi 3. i këtij neni. 3. Para se t'i zbatojë ndryshimet e tilla, punëdhënësi i njofton paraprakisht me shkrim një (1) muaj më parë të punësuarit dhe sindikatën e të punësuarve, nëse janë të anëtarësuar në sindikatë, lidhur me ndryshimet e planifikuara dhe me pasojat e tyre, duke përfshirë: 3.1. numrin dhe kategorinë e të punësuarve që duhet të largohen nga puna; 3.2. masat që duhet të ndërmerren punëdhënësi, nëse ka të tilla, për ti zbutur pasojat e largimit kolektiv...". Në rastin konkret, edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, del se e paditura nuk ka vlerësuar objektivisht dhe në mënyrën e arsyeshme mundësitë e saja për risistemimin e punëtores, në këtë rast të paditëses dhe dhënien e mundësisë asaj që të angazhohet në detyra të njëjta të punës apo detyra të përafërta, pasi që konstatohet se e paditura me datën 08.04.2014, e ka pranuar një punëtoresh tjetër në vendin dhe detyrat e punës të ngjajshme në të cilat ka qenë e sistemuar këtu paditësja. Qëndron fakti se e paditura pastaj e ka ftuar paditësen që të aplikoj në disa pozita në kuadër të saj, por se ftesat kanë qenë kryesisht për vende pune në lokacione dhe qytete të tjera dhe përderisa me datën 08.04.2014, e paditura, në vendin e punës në të cilin ka punuar paditësja deri me datën 30.03.2013, e pranon një punëtoresh të re, atëherë edhe gjykata ankimore e pranon qëndrimin e gjyktës së shkallës së parë se veprimet e paditëses me të cilat është ftuar e paditura për aplikim në vende dhe lokacione të tjera, kanë karakterin e veprimeve formale përmes të cilave tentohet të respektohet neni 76 i LP të sipërcituar. Në bazë të shkresave të lëndës gjithashtu është provuar fakti se përgjatë kohës sa ka punuar tek e paditura ndaj paditëses nuk ka pasur ndonjë vërejtje lidhur me kryerjen e detyrave të punës, prandaj mosangazhimi i paditëses në pozita të tjera për të cilat ajo është gjetur dhe treguar të jetë e përshtatshme, përderisa në anën tjetër janë angazhuar persona të tjerë me më me pak përvojë në raport me paditësen, edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit rezultojnë të jetë veprim i paarsyeshëm i të paditurës si punëdhënëse në këtë rast, në raport me këtu paditësen si punëmarrëse.

Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë ka vepruar gjykata e shkallës së parë ku i'a ka falur besimin ekspertizës plotësuese të ekspertit finaciare të datës 22.05.2017, përmes të cilës kjo e fundit ka bërë llogaritjen e diferencës së pagës të cilën do ta realizonte paditësja, pasi që e njëjta në ndërkohë ka punuar në Ministrinë e Administratës Publike duke realizuar të ardhura mujore në shumat respektive, për çka gjykata e shkallës së parë, i'a ka njohur paditëses të drejtën në kompensimin e të ardhurave/diferencën e pagave vetëm në periudhën përgjatë së cilës paditësja nuk ka realizuar të ardhura askund, si dhe të ardhurat e tjera që kanë të bëjnë me pagesën e trustit pensional për kohën kontestuese, tatimit në pagë dhe kamatën ligjore të llogaritur sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), të cilin vendim e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm edhe gjykata e shkallës së dytë.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin në fjalë gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për Gjykatën e Apelit, është pretendim i pathemeltë. Aktgjykimi i atakuar është mjaft i qartë si në pjesën e dispozitivit ashtu edhe të arsytimit, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritore.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.4296/17, me datën 23.10.2018**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Valon Totaj**